



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 18.12.2013, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Prezantimi dhe shqyrtimi në parim i projektligjit “Për buxhetin e shtetit të vitit 2014”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Armando Subashi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Edi Paloka, Eduard Halimi, Kastriot Islami, Keltis Kruja, Mark Frroku, Petrit Vasili, Dashamir Peza, Spartak Braho, Tom Doshi, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Pirro Lutaj, Nard Ndoka, Tahir Muhedini, Gjovalin Bzheta, Arben Ristani dhe Vexhi Muçmataj.

Mungojnë:

Blendi Klosi, Ermonela Felaj, Gent Strazimiri, Luan Duzha dhe Mhill Fufi

Të ftuar:

Shkëlqim Cani – Ministër i Financave

Mimoza Dhëmbi – drejtoresha e Përgjithshme e Buxhetit.

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Mirëmëngjesi!

Sot në rend të ditës kemi prezantimin dhe shqyrtimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e shtetit të vitit 2014”.

I pranishëm në mbledhje është ministri i Financave, zoti Shkëlqim Cani.

Meqenëse deputetët e njohin tashmë buxhetin dhe vetë ministri ka bërë një paraqitje publike duke na vënë në dispozicion një përmbledhje të këtij projektbuxheti, do t’i lutesha ministrit të na e parashtrojë atë sa më shkurt.

Fjala për ju, zoti Ministër.

Shkëlqim Cani – Shumë shkurt do t’ju parashtroj si mbyllet viti 2013. Shifrat janë në përmirësim. Mendohet që të ardhurat në fund të vitit nuk do të jenë 320 miliardë, por afërsisht 326 miliardë lekë. Deficiti do të jetë diku te 6% dhe borxhi publik diku te 69%. Rritja ekonomike mendohet të jetë 1,3%.

Si do të jetë viti 2014 nisur nga kjo situatë e vitit 2013? Mendohet që të ardhurat të jenë pak më pak se 364 miliardë lekë, në fakt janë 363 e 966, ku rriten me 42 miliardë lekë të ardhurat. Deficiti mendohet te 6,6%, borxhi publik është një shifër në diskutim me FMN-në për t’u rakorduar mënyra e raportimit. Ata gjykojnë që ne duhet të raportojmë 72,6, ne gjykojmë 74,8%. Sido që të jetë, me të rakorduar nga ana teknike, ne do të tregojmë se sa është deficiti. Ne kemi marrë shifrën më konservative për ta pasqyruar këtu. Rritja ekonomike mendohet rreth 2%, pra pak më mirë se sivjet, por përsëri jo në ato tempe që do të dëshironte ekonomia.

Disa momente kryesore të buxhetit janë që ky buxhet synon rivendosjen e stabilitetit makroekonomik, është i domosdoshëm, nuk po e argumentoj pse. Është buxhet me disiplinë të fortë në financat publike, mbështetet nga një paketë fiskale tërësore, ku ka sigurinë plus 18 miliardë lekë. Parashikimet janë bazuar në tregues makro-ekonomikë jo si më parë, por sa më realist në bashkëpunim me FMN-në dhe me Bankën Botërore. Ky buxhet shlyen në mënyrë graduale detyrimet e krijuara në vite, pra borxhin e prapambetur. Ky buxhet ka një shumë afërsisht 350 milionë dollarë për të shlyer borxhet. Në qoftë se do të duam të bëjmë një krahasim, paketa i sjell buxhetit plus 18 miliardë lekë. Sikur edhe ne të mos shlyejmë detyrimet siç është bërë më parë, ne nuk do ta donim

fare paketën, përkundrazi me të njëjtin temp ne mund të realizonim edhe 18 miliardë të ardhura më shumë, por ne e kemi marrë këtë zotim për të shlyer detyrimin ndaj biznesit dhe do ta paguajmë këtë shumë 350 milionë dollarë. Vendoset një sistem i shëndetshëm që nuk lejon më krijimin e detyrimeve të prapambetura. Duke filluar nga janari i vitit 2014 ne likuidojmë në mënyrë automatike nga thesari pagesat për biznesin kur është rimbursimi i TVSH-së ose kur paraqitet fatura. Jepet mbështetje prioritare në sektorët kryesorë: arsim, shëndetësi, bujqësi dhe infrastrukturë.

Për investimet janë dy kënde vështirësi të drejtpërdrejta, janë 65 miliardë lekë plus 10 miliardë lekë në zhvillimin rajonal, si dhe 12 miliardë lekë që janë shlyerje detyrimesh të prapambetura, po të shtojmë edhe 23 të tjera që shlyejmë TVSH-në, pra në tërësi buxheti prodhon likuiditet për biznesin, për punë për t'i dhënë mundësi biznesit për t'u zhvilluar më tej rreth 1 miliard ose diçka më shumë se 1 miliard dollarë.

Gjithashtu, ka mbështetje për aspektin social ashtu siç qeveria është zotuar. Janë dy komponentë: një është paaftësia, ndihma ekonomike dhe tjetra është mbështetja sociale. Për herë të parë jepet e gjithë sasia e nevojshme për ndihmë ekonomike dhe për invalidët. Që këtë vit ne do të shlyejmë 1/3 e detyrimit të prapambetur prej 6 miliardë lekësh, ndërkohë gjatë vitit 2014 nuk do të krijohet asnjë detyrim i prapambetur, përkundrazi do të shlyhet edhe detyrimi i prapambetur për ta. Njëkohësisht janë 1,1 miliardë lekë për shtresat në nevojë, për energji dhe për pesë artikujt bazë ushqimorë.

Në nivel shpenzimesh ajo që ka hapur shumë debate dhe diskutime është fakti i lidhur me pushtetin vendor. E vërteta është që pushtetit vendor me këtë buxhet i jepen 33 miliardë lekë ose 2,4% e prodhimit të brendshëm bruto nga 28,6 miliardë lekë ose 2,1% e prodhimit të brendshëm bruto që i jepej në vitin elektoral 2013, pra rritet me 15,6%. Nuk mbetet asnjë komunë, asnjë bashki pa marrë më shumë nga çfarë ka marrë në vitin 2013, ndërkohë bashki të veçanta marrin edhe më shumë. Kuptohet, gjithçka bazohet në një formulë të caktuar.

Fondi i zhvillimit të rajoneve pothuajse dyfishon fondet.

Ka një rritje të nivelit të pagave të policisë, 25% siç ishte zotimi për 93% të efektivave.

Jepet një fond kompensimi për fermerët, 600 milionë lekë. Siç ju thashë, jepet 1,1 miliardë lekë si kompensim për shtresat në nevojë. Për kujdesin shëndetësor jepen 2,2

miliardë lekë, jepet më shumë nga vitet e tjera. Realizohet një premtim për diagnostikimin e përgjithshëm falas për shtetasit me moshë 40-60 vjeç dhe njëkohësisht bëhet furnizimi me medikamente të onkologjisë dhe kardiologjisë, si dhe premtimi tjetër që është hequr TVSH-ja për ilaçet, për 10%, që, në fakt, do të sjellë ulje çmimi diçka më shumë se 10%. Ne presim të jetë një ulje diku më afër 15% sesa 10%.

Ka disa investime me financim të huaj: kanalizimet e Durrësit për ujin e pijshëm nga Banka Botërore, informatizimi i sistemit shëndetësor, realizohet dhe modernizohet sistemi i asistencës sociale.

Nuk po ndalem te sektorët prioritarë që marrin nga 4-5%, pra marrin më shumë fonde nga të tjerët.

Në fund, ajo që vlen për t'u theksuar është që do të shlyejmë 35 miliardë nga borxhi. Këtë më duhet ta theksoj, sepse edhe këtu ka një keqkuptim, se borxhi i prapambetur nuk është ky, është shumë më i madh, por borxhi i prapambetur do të certifikohet me auditorë ndërkombëtarë. Ne do të shpallim shpejt tenderin ose jemi në bisedime me BE-në të na i japin ata fondet dhe do ta bëjnë ata, por edhe pjesa tjetër e borxhit, e cila është shumë më e lartë nga kjo që ne marrim zotimin për të shlyer këtë vit, do të jetë pjesë e certifikimit nga auditorët ndërkombëtarë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Ministër!

Besoj se për kolegët është e qartë.

Atëherë, kalojmë te pyetjet. Disa nga kolegët dje kanë ngritur disa pyetje, për të cilat do të përgjigjet ministri. Do desha që kolegët t'i riformulonin pyetjet, meqenëse është prezent ministri.

Zoti Islami, urdhëroni!

Kastriot Islami – Faleminderit, zoti Ministër!

Duke mos pasur shumë kohë për ta lexuar në detaje dhe në thellësi materialin, ndoshta edhe në seancë plenare do të ketë pyetje të tjera. Pyetja ime e parë lidhet me faktin se ju thoni se është një programim realist i bërë në një marrëveshje me Fondin Monetar Ndërkombëtar. A mendoni se gjatë vitit do të ketë rishikim të buxhetit dhe në çfarë drejtimi do të ketë, sidomos për rritjen ekonomike, për të ardhurat, për borxhin dhe për deficitin. Parashikoni që gjatë vitit këto parametra mund të ndryshojnë dhe në çfarë

drejtimi janë pritshmëritë, duke pasur parasysh risqet, rrethanat, por dhe mundësitë që mund të ketë për t'u rritur apo për t'u zvogëluar?

E dyta. Doja të dija saktësisht, sepse aty është vlera totale e doganave dhe tatimeve: sa janë në terma të prodhimit bruto të ardhurat për doganat? Në qoftë se e keni, në qoftë se nuk e keni mund të na e dërgoni. Pyetja lidhet me këtë që do të them më poshtë: a e përfshin kjo vlerë edhe suksesin prej rreth 1 për qind nga pjesëmarrja ose nga asistenca e *Crow Agents*, apo kjo është lënë në varësi të suksesit të kësaj kompanie për t'u përfshirë në një ndryshim të mundshëm të buxhetit? Besoj se është e qartë pyetja?

Pyetja tjetër është: sa për qind mendoni ju se do të rriten nga performanca në dogana dhe tatime dhe çfarë konkretisht do të bëni në dogana dhe tatime për të rritur performancën?

Pyetja tjetër ka të bëjë më tepër me një konfirmim. Ju thoni se do shlyeni 35 miliardë detyrime, nga të cilat 12 miliardë janë përpunime të infrastrukturës dhe 20 miliardë janë për detyrimet tatimore. Sa janë detyrimet e kompanive ndaj buxhetit të shtetit dhe do të ndërmerrni ndonjë veprim për të tërhequr pikërisht detyrimet e kompanive ndaj buxhetit të shtetit?

Pyetja tjetër është më tepër sqaruese. Ju thoni se pushteti vendor do të marrë më shumë në tema të prodhimit bruto këtë vit sesa është marrë një vit më parë. Përfshini në këto të ardhura dhe taksën vendore, apo pavarësisht taksës vendore, e cila do të grumbullohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe do të shpërndahet sipas rregullit në 10-ditshin e parë? Pra, në këtë shumë përfshihet taksa vendore?

Pyetja tjetër është më tepër kuriozitet. Ju thoni se akciza për cigaret do të rritet 10 lekë për paketë, me qëllimi që shqiptarët të pinë më pak cigare, të paktën kështu m'u duk mua në një shpjegim që keni dhënë, ndërkohë që ju keni bërë një llogaritje se nga kjo do të vijë në buxhet 1.5 miliard, bazuar në 3600 tonë cigare, aq sa janë grumbulluar dhe një vit më parë. Pra, në qoftë se rritet akciza, do të pinë më pak cigare, apo llogaritja është bërë se do të pinë po aq cigare sa në vitin 2013? Inshalla pinë më pak cigare dhe nuk ka rëndësi se do të mblidhen me pak të ardhura.

Një pyetje që ua bëra dy përfaqësuesve, që në fakt me të drejtë ata thanë se ministri mund të japë një përgjigje, dhanë një përgjigje të pjesshme, Ju keni sjellë paketën dhe buxhetin në të njëjtën kohë, normalisht (më fal që po bëj një koment të zgjatur, zoti

drejtues i mbledhjes) do të mbarojë paketa fiskale, të miratohet, aty dalin dhe të ardhurat, pastaj fillon debati për buxhetin, ku pjesa më e rëndësishme janë të ardhurat. Ka fleksibilitet te paketa fiskale për të ndryshuar diçka, e cila pastaj do të ketë impakt te buxheti?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më tepër dua të di a ka fleksibilitet në debatin që bëhet në parlament për të ndryshuar paketën.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pyetja ime është kështu: a ka fleksibilitet te paketa për të ndryshuar diçka që do të ketë një impakt te buxheti, të cilin, me sa kuptova dje nga një përgjigje e pjesshme e dy kolegëve, njëri ministër dhe tjetri zëvendës, është i negociuar me Fondin Monetar Ndërkombëtar, apo jo?

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Islami!

Zoti Ministër, urdhëroni për përgjigjet!

Shkëlqim Cani – A do të ketë rishikime buxheti? A është fleksibël ideja, për shembull, për efekt të rritjes ekonomike të të ardhurave dhe të shpenzimeve?

Po, buxheti është fleksibël. Buxheti është fleksibël (madje kështu kemi rënë dakord edhe me misionin e FMN-së dhe me Bankën Botërore) rast se ekonomia performon më keq nga ç'është pritshmëria, atëherë FMN-ja, Banka Botërore dhe qeveria do të jenë më fleksibël për t'i dhënë nxitje rritjes ekonomike. Në qoftë se ekonomia performon më mirë, atëherë ne do të jemi në krahun që të shlyejmë më shpejt borxhin dhe detyrimet, pra si rritja ekonomike, ashtu dhe të ardhurat dhe shpenzimet, që vijnë për pasojë të njëra-tjetrës, do të jenë fleksibël.

Lidhur me pyetjen se sa janë të ardhurat nga doganat në përqindje, besoj se ju e lidhni këtë pyetje me *Crown Agents*, pra a është zbatuar ajo. Kjo është një pyetje e vazhdueshme, që i jam përgjigjur disa herë, edhe deputetëve të grupit socialistë, që e kanë pasur merak gjatë gjithë kohës, sepse është çështja e informalitetit, e evazionit fiskal dhe bashkë me të edhe *Crown Agents*. Kur bëhet një buxhet, besoj se duhet të jetë e përbotshme, sidomos aty ku është FMN-ja, dhe nuk pranohet që buxheti të bëhet në bazë të uljes së informalitetit dhe të uljes së evazionit fiskal. Gjatë performancës më të mirë

buxheti rishikohet pozitivisht në bazë të performacës më të mirë. Ky është një parim i zbatuar në Shqipëri gjatë këtyre 20 vjetve. Natyrisht që performanca e administratës nuk është zero, por jo tej një kufiri të caktuar, që quhet “kufi i logjikshëm”. Përtej këtij kufiri Banka Botërore, FMN-ja dhe të gjitha buxhetet e Shqipërisë në vite nuk japim më shumë se kaq. Nëse ju kujtohet, ka pasur periudha kur buxhetet në Shqipëri janë rishqyrtuar në mes të vitit, kur kanë performuar më mirë, për të bërë rishpërndarje fondesh ose për të shlyer borxhin. Ky është një parim i njohur, fjali të tilla si: “Dëshira e mirë për të performuar më mirë, sepse evazioni, informaliteti janë shumë të lartë...” etj. janë të dëgjuaara prej dy dekadash. Ato duhet të reflektohen kur të jenë realizuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Shifra nga performanca në këtë buxhet është afërsisht 13 miliardë lekë. Shtesa është 39,5. Nga tatim-taksat heqim 18 paketën, heqim 8-9 nga rritja ekonomike dhe del diferenca. Këto shifra besoj i konsultojmë më vonë.

Të ardhurat e vitit 2013, me sa duket, do të realizohen po 326 miliardë, por ne presim ende, sepse ka edhe gjysmë muaj për t’u sakatuar këto. Pra, ne presim të realizohen dhe pastaj të themi se sa do të jetë kjo shifër. Kuptohet që çdo buxhet ndërtohet në bazë të pritshmërive të vitit të kaluar, kështu që në ditët që jemi duke diskutuar, sa më shumë të garantohemi për shumën, aq më shumë do të mund të reflektojmë edhe për buxhetin e vitit 2014, nëse do të jetë nevoja.

Lidhur me shlyerjen e 35 miliardë lekëve, 23 janë TVSH dhe tatimfitim i parapaguar, kurse 12 miliardë janë shlyerje detyrimesh të vonuara ndaj biznesit, kryesisht në infrastrukturë.

Për sa u përket detyrimeve të kompanive, unë nuk e kujtoj shifrën e saktë, por është shumë goxha e madhe dhe do të bëhen të gjitha përpjekjet që edhe ky borxh të kthehet. Kjo është pjesë e performancës së administratës fiskale. Shumë nga këto detyrime janë edhe 10 apo 20-vjeçare, pra pritshmëritë lidhur me këtë çështje mund të mos jenë të mëdha.

Për sa i përket pyetjes nëse përfshihet taksa vendore te buxheti vendor, parimi është i qartë. Administrata qendrore do të mbledhë para për llogari të pushtetit lokal. Ne nuk do t’ia marrim pushtetit lokal, por vetëm do të mbledhim taksat. Është parashikuar që

gjithçka t'i shkojë pushtetit lokal, madje shumë më tepër nga ç'ka marrë vitet e tjera. Pra, nuk do t'ia marrim ne, nuk i merr pushteti lokal.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, do të kalojë e gjitha. Ne nuk i marrim asgjë. Pra, rritja është 15,6%, duke i dhënë edhe pjesën që i takon, sepse nuk është jona.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lidhur me akcizën e cigares, ajo nuk do të jetë 10 lekë, por 20 lekë në vitin 2014. Niveli i cigareve është marrë po ai i vitit 2013, pra 3600 tonë. Kemi llogaritur uljen e konsumit të duhanit, por kemi shtuar evazionin, kështu që, meqenëse me duhanet është luajtur gjithmonë, ne do të shtojmë kontrollin, prandaj e morëm edhe *Crown Agents*, njëkohësisht shpresojmë tek administrata për një punë më të mirë. Në këtë mënyrë nuk do të lejohet më evazion. Shifra 3600 tonë është shifër shumë pranë joreales. Shifra reale e importit të duhaneve është shumë më e madhe.

Për sa i përket pyetjes së fundit, pra nëse ka fleksibilitet dhe nëse paketa fiskale ndryshon në një nga elementet e veta, do të thosha se negociatat me FMN-në nuk janë të lidhura drejtpërdrejtë. Çdo dështim në të ardhura natyrisht që do të sjellë ulje të shpenzimeve. Do të ruhet deficit, ai që është rregull i artë i përhershëm i çdo buxheti. Fiksohet deficit dhe pastaj punohet me shpenzimet. Paketa i ka elementet e duhura për të mos pësuar asnjë ndryshim. Sido që të jetë, ky është gjykimi ynë si qeveri. Në varësi të ecurisë, do të shikojmë edhe elementet e shpenzimeve.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Janë bërë disa kërkesa për të bërë pyetje.

Më thonë se ka kohë edhe 10 minuta.

(Diskutime pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj - Zoti Paloka, urdhëroni!

Edi Paloka – Pyetjen që bëri zoti Islami për duhanin, unë e kam për naftën dhe për rritjen e taksës së transportit. Ju, pak a shumë, keni nxjerrë të njëjtin argument ku thoni se mjedisi është qëllimi juaj kryesor. Pra, kjo presupozon se shqiptarët do të blejnë më pak naftë nga çmimi i rritur dhe kështu do të harxhohet më pak naftë dhe do të ketë mjedis më të pastër. Në llogaritë që keni bërë për buxhetin, a e keni llogaritur që nafta do të harxhohet në të njëjtën sasi, por me çmim më të lartë? Dua një shpjegim për këtë.

E dyta, jo më larg se dje edhe deputetët e PS-së ngritën me të drejtë probleme për disa taksa, siç është ajo për shtëpitë e qytetarëve para vitit '93 e më tej. Pra, ka kundërshtime me logjikë edhe nga deputetët e majtë për paketën tuaj fiskale. Në qoftë se kjo paketë nuk kalon, si do t'i bëni llogaritë e buxhetit, sepse për këtë ne kemi kërkuar dhe këmbëngulur që më parë të kalonte paketa, siç ka qenë gjithmonë procedura dhe pastaj të vinte buxheti? Ju i keni sjellë të dyja menjëherë. Në qoftë se paketa fiskale rrëzohet në parlament, çfarë do të bëni me projektbuxhetin?

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti Cani, urdhëroni!

Shkëlqim Cani – Lidhur me naftën është e njëjta përgjigje. Të gjithë artikujt me akcizë janë artikujt me evazionin më të madh. Kështu që pritshmëritë janë për një punë më të mirë lidhur me zbulimin e rasteve të evazionit. Janë marrë disa masa për të shmangur evazionin në industrinë e naftës, për arsye se aty ka pasur spekulim shumë të madh lidhur me pagimin e tatim-taksave.

Lidhur me paketën dhe buxhetin ne i kemi sjellë si një e tërë. Është e drejta e Kuvendit për të gjykuar. Mund t'ju them se parimi është i qartë: nëse vendoset diçka për të ardhurat qoftë në rritje, qoftë në ulje, për pasojë do të veprohet me shpenzimet, si në rritje dhe në ulje.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti Majko, urdhëroni!

Pandeli Majko – Zoti Cani, unë mund t'jua bëj kërkesën edhe me shkrim, por sinqerisht fjalën tuaj e filluat duke përmendur borxhin prej 350 milionë dollarësh që ka gjetur qeveria shqiptare karshi biznesit. E kam lexuar me shumë vëmendje relacionin dhe për këtë borxh prej 350 milionë dollarësh ka vetëm një gjysmë faqe A4. Në faqen 30 thuhet: “detyrime të prapambetura” dhe fillon me “së fundi”, a thua se është ndonjë gjë që ka mbetur si bisht që nuk duhet vlerësuar aq shumë. 350 milionë dollarë janë shumë. Mendoj se Ministria e Financave duhet të bëjë një raportim shtesë. Pyetja ime është: a do të ketë një raportim shtesë me shkrim për këto 350 milionë dollarë? Kur janë marrë? Kujt

i janë marrë? Si janë marrë? Sepse nuk janë detyrime të prapambetura. Pra, a janë detyrime të prapambetura që nuk janë miratuar nga parlamenti i Shqipërisë?

Zonja Dhëmbi është punonjëse e vjetër, është drejtoreshë e Thesarit. Për të gjitha detyrimet prej 350 milionë dollarësh, në masën më të madhe, sidomos për biznesin e rrugëve, ka pasur një debat të vjetër në Komisionin e Ligjeve, ku qeveria e mëparshme nuk e ka njohur këtë borxh. Parlamenti duhet të njoftohet, sepse bëhet fjalë për shpenzime që nuk janë detyrime. Detyrime do të ishin në rastin më të mirë nëse do të ishin miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë në buxhetet paraardhëse. Bëhet fjalë për punimet e kryera jashtë kontekstit të miratuar nga parlamenti i Shqipërisë. E kuptoj se nuk ka pyetje eksplicite për këtë, por është një çështje sa ligjore, aq edhe problematike në marrëdhënie me këtë buxhet.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti Ministër, urdhëroni!

Shkëlqim Cani – Të jeni i sigurt që ne nuk kemi ndërmend të paguajmë ato që nuk janë të ligjshme dhe që nuk janë detyrime. Shtesë ne nuk do të bëjmë, por ju garantoj se të gjitha ato janë punime dhe shërbime të kryera ndaj qeverisë, të faturuara, të papaguara. Për këtë ne angazhuam *Deloitte&Tousche* që t'i shikonte faturat një për një.

Së dyti, është TVSH-ja dhe tatimfitimi i parapaguar, që nuk i është kthyer biznesit, siç janë ligjet në fuqi. Ne kemi deklaruar dhe përsëri deklarojmë se këto fatura po rishqyrtohen nga ministritë përkatëse dhe pasi të rishqyrtohen do të vijë një auditor që do të bëjë vlerësimin mbi bazë risku. Pra, ne do të bëjmë gati një paketë të këtyre shlyerjeve prej 35 miliardë lekësh. Ju thashë është një auditor që do të shpallet ose nga ne, mbi bazën e një tenderimi ndërkombëtar, ose do të na e sjellë BE-ja me fondet e veta dhe ai do të përzgjedhë në paketë mbi bazë risku një përqindje të caktuar të projekteve dhe nëse do të vlerësoj se këto detyrime janë të qeverisë shqiptare ndaj biznesit ne do të bëjmë pagesën për shumën prej 35 miliardë lekësh. Pra ne nuk do të bëjmë asgjë përtej asaj që është ligjore. Këto janë detyrime të vjetra prej vitesh. Ne e gjejmë se është një borxh i qeverisë ndaj biznesit që duhet shlyer.

Zoti Majko, unë nuk dua të bëj politikë këtu. Shqiptarët dhe ndërkombëtarët njohin një shtet, shtetin shqiptar, pavarësisht nga ndërrimi i qeverive. Qeveria duhet ta

mbajë zotimin. I kemi paguar edhe herë të tjera detyrimet e njëri-tjetrit. Madje kemi paguar edhe detyrimet e komunizmit.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Ministër!

Zoti Vasili, urdhëroni!

Petrit Vasili – Në relacionin e buxhetit është bërë një shtesë për shëndetësinë, e cila është referuar për aparaturën në fushën e Onkologjisë dhe për depistimin falas. Ndërkohë ministri tha edhe për barnat në fushën e Onkologjisë.

Së dyti, u tha se me heqjen e TVSH-së së barnave hamendësohet që ulja e çmimit mund të shkojë deri në 15%. Pyetja ime është: ku bazohet një hamendje e tillë, ndërkohë që volumi i qarkullimit të barnave në treg, për hir të të njëjtit buxhet, mbetet po ai, pra nuk ka asnjë ndryshim? Është shumë e qartë, kush e njeh dinamikën, se nuk ka asnjë premisë që çmimet të ulen më tej duke pasur të njëjtat volume të konsumit të barnave.

Shkëlqim Cani – Unë nuk jam i sigurt nëse janë barna ose pajisje, më konfirmojnë se janë barna. Ajo që vlen të theksohet është çështja e dytë. Ulja 10% është ulje automatike, sepse hiqet TVSH-ja. Ju, zoti Vasili, e dini që barnat janë me çmime të kontrolluara. Meqenëse është një reformë tërësore, që nuk do të prekë vetëm heqjen e TVSH-së, por do të revizionohet i gjithë sistemi i çmimeve të barnave, nga Ministria e Shëndetësisë, në bashkëpunim me ministrin e Shëndetësisë, është gjykuar se do të ulet (unë ju thashë do të jetë në intervalin nga 10 deri në 15, por më pranë 15-s) jo vetëm 10%-shi, që është e sigurt, por do të tentohet të ulet edhe me reformën tërësore një pjesë tjetër nga çmimi i barnave.

Petrit Vasili – Ndoshta informacioni nuk është i plotë. Ne kemi marzhet më të ulëta që ekzistojnë në Europë për çmimet e barnave. Kemi marzhe fitimi deri në 6%. Cila është reforma, a do të shkojë marzhi i fitimit deri në 2%? Të flasim realisht, sepse ndoshta duke mos pasur realizëm krijohet një skenar që nuk është i vërtetë. Këto janë të vërtetat. Ne kemi çmime të kontrolluara dhe me marzhe të supërkontrolluara, të cilat shkojnë deri në minimumet e tyre në barna shumë të shtrenjta. Kam frikë se kjo është një hamendje jorealiste.

Shkëlqim Cani – E rëndësishme për diskutimin e buxhetit është që ne kemi parashikuar vetëm 10%-shin në buxhet, por gjykimi ynë është se do të jetë më tej në

bashkëpunim me Ministrinë e Financave. Ne e kemi këtë reformë në bashkëpunim dhe nën udhëheqjen e Ministrisë së Shëndetësisë, sepse nuk jemi ne ata që mund ta menaxhojmë këtë situatë, ne vetëm ndihmojmë. Ajo që ka parashikuar buxheti është ulja e 10%-shit, dhe kaq kemi bërë, ndërsa pjesa tjetër është pritshmëria që ne kemi mbi bazën e lëvizjeve në marzhe, mbi bazën e disa faturave, të cilat në vetvete kanë disa elemente shtesë, zbritje, që realizojnë firmat e huaja. Le ta shohim dhe të presim efektin. Ne shpresojmë që të anojë më shumë nga 15-a. Sido që të jetë, buxheti është konservativ, ka marrë vetëm 10%-shin.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti Ministër, mund të largoheni, ndërsa zonja Dhëmbi do të jetë në Komision, si gjithmonë.

Zoti Ministër, shumë faleminderit për shpjegimet tuaja!

Kush ka pyetje? Zoti Ristani ka pyetje.

Arben Ristani – Ka pasur një premtim se borxhi ndaj biznesit do të shlyhet me një këst, i plotë dhe përpara se të ngrihen taksat. Sipas buxhetit që po planifikoni, a do ta shlyeni të plotë, me një këst dhe përpara se të ngrihen taksat për biznesin?

Çdo ditë po propagandoni se do të ulen taksat për 97% të shqiptarëve. Nga informacioni që kam, 56,4% e shqiptarëve kanë paga deri në 30 mijë lekë të reja. Pra, nga ky 97-përqindësh që ju thoni se do t'u ulni taksat, 56,4% e këtyre kanë paga deri në 30 mijë lekë. A mendoni se ju qëndron shifra se do të ulni taksat për 97% të popullsisë?

Pagave mbi 90 mijë lekë të reja në muaj, duke qenë se do të hiqet tavani i sipërm për kontributet e sigurimeve shëndetësore, sa do t'u shtohet pagesa për sigurimet shëndetësore në muaj?

Duke qenë se keni propaganduar se do të shlyeni pagesat ndaj të përndjekurve politikë, sa më shumë se qeveria “Berisha” keni parashikuar të shlyeni këtë vit? Domethënë, sa më shumë lekë se qeveria “Berisha” keni planifikuar këtë vit për të përndjekurit politikë? Sa keni planifikuar më shumë se qeveria “Berisha” për të kompensuar ish-pronarët?

Në lidhje me pensionistët, duke qenë se nuk keni planifikuar shtim të pensioneve, si do të veprohet për të kompensuar inflacionin, taksën e shtëpisë dhe taksën e karburantit që u shtohet atyre?

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Po, zonja Dhëmbi.

Mimoza Dhëmbi – Pyetja e parë ka të bëjë me borxhin ndaj biznesit. Në fakt, rritja e taksave do të fillojë nga 1 janari, kështu që më 1 janar nuk ka asnjë plan që të jetë i shlyer i gjithë borxhi. Kjo nuk ka sens. Procesi i shlyerjes së borxhit do të kërkojë një kohë. Siç e shpjegoi ministri, do të ketë një ekspert ndërkombëtar, që do të auditojë dhe mbikëqyrë të gjithë procesin. Do të ketë një proces tenderimi, ku do të zgjidhet një ekspert ndërkombëtar. Nëse këtë ekspert do të na e sjellë BE-ja me procedura më të përsheptuara, kjo do të jetë në të mirë të procesit. Sidoqoftë, detyrimisht do të ketë një ekspertizë mbi procesin e dhënies së këtij borxhi që është parashikuar, kështu që procesi nuk mund të fillojë para marsit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Edhe ministri e shpjegoi se ka një proces identifikimi. Pjesa që është identifikuar dhe certifikuar është futur në buxhetin e vitit 2014 dhe është 35 miliardë lekë. Në fakt, ky nuk është i gjithë borxhi i prapambetur, sepse pjesa tjetër do të jetë në proces identifikimi. Pra, duhet certifikuar, pastaj duhet dhënë. Pjesa e certifikuar do të jepet njëherësh.

Debati për përqindjen e popullsisë që do përfitojë nga taksa progresive është politik. Rëndësi ka që nga kjo taksë ne kemi minus në buxhet, pra ka përfitim. Kanë përfitim të punësuarit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Tatimi për personat që marrin deri në 30 mijë lekë u hoq më 1 maj këtë vit. Është politikë e këtij viti.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ky është debat politik dhe nuk është për mua. Unë isha dhe jam.

Është e vërtetë që pagat mbi 95 mijë lekë do ta paguajnë kontributin e sigurimeve shëndetësore pa tavan. Duke qenë se është vetëm 1,7% për të punësuarit, sepse 1,7% paguhet nga punëdhënësi, pra ne kemi parashikuar edhe më shumë para të kontributit si punëdhënës për punonjësit buxhetorë. Mendoj se është një shumë e pakonsiderueshme për rrogat mbi 95 mijë lekë, që janë rroga të konsiderueshme. Pra, po të marrësh një rroge 100 mijë lekë me një rrogë 95 mijë lekë të vjetra, diferenca nuk është as 1000 lekë të

vjetra. Pastaj, sa më shumë të rritet paga, kuptohet që kjo rritet. Po flasim për nivelin e pagave të shtresës së mesme.

Për ish-të përndjekurit kemi vendosur shumën 1,8 miliard, aq sa ka qenë mesatarja e viteve të kaluara, duke përfshirë vitin 2013, që ishte 3 miliardë lekë. Ndoshta edhe për shkak të vitit zgjedhor, fondi ishte pak më i rritur. Ky është normalisht fondi mesatar që japim në një vit. Kaq mban barra e buxhetit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo më shumë se viti 2013, por në krahasim me vitet e tjera është aty-aty.

Sa më shumë paguhet për ish-pronarët?

Ju e dini se për ish-pronarët kemi një fond që vjen nga të ardhurat nga legalizimi, të cilat shkojnë 100% për ata. Një fond i vogël prej 100 milionë lekësh shkon për pronarët e vjetër, që është i barabartë me të gjitha vitet e tjera të qeverisjes së mëparshme. Pra, nuk ka më shumë, është i njëjti fond.

Për sa u përket pensionistëve, ne (nuk e di në keni parë te relacioni) kemi një fond për indeksimin e pensioneve, që është 2%, aq sa është inflacioni, sepse e kemi detyrim ligjor dhe nuk mundëm ta shmangnim. Me gjithë politikat që u kërkuan për ngrirjen e pensioneve dhe të pagave, këtë mundëm të realizojmë. 2%-shi për indeksimin e pensionistëve është i përfshirë në buxhet.

Për efektet e taksave dhe të politikave të tjera kemi parashikuar një fond kompensimesh prej 1,1 miliard lekësh, në qoftë se do ta shikoni në tabelat e buxhetit, e cila do të kompensojë shportën bazë për shtresat në nevojë dhe një pjesë të kostos së TVSH-së për energjinë, meqenëse ishte parashikuar që TVSH-ja për energjinë do të ulej. Ne nuk e kemi ulur. Pra, nuk e kemi hapur shtegun e përfshirjes tek TVSH-ja, por kemi parashikuar një fond kompensimesh për shtresat në nevojë, që do të jenë shtresat që përfitojnë ndihmë ekonomike, paaftësi. Natyrisht, këtu do të hyjë edhe pjesa e pensionistëve.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Dhëmbi!

Fjalën e ka zoti Vasili.

Petrit Vasili – Zonja Dhëmbi, në faqet 28 dhe 51 ka dy referime për të njëjtën çështje. Në faqen 28 thuhet: “Furnizim më i mirë me medikamente për shërbimin e onkologjisë dhe të kardiologjisë”. Pastaj te 51-shi thuhet: “Janë parashikuar për

përmirësimin e shërbimit të onkologjisë dhe të kardiokirurgjisë”. Mjekësia dhe financa janë dy gjëra të ndryshme. Shërbimi dhe barnat janë dy gjëra të ndryshme. Shërbimi ka elementet e veta, kurse barnat janë tjetër gjë. Ose qëndron njëra, ose qëndron tjetra. Me këtë gjuhë krijoni konfuzion. Barnat janë një nga elementet e shërbimit dhe nuk janë më thelbësori.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Vasili!

Fjalën e ka zonja Dhëmbi.

Moza Dhëmbi – Në fakt, unë kam qenë negociatore për buxhetin e shëndetësisë, flitet për furnizimin më të mirë me medikamente të onkologjikut dhe të kardiokirurgjisë. Ky ka qenë objektivi. Ndoshta është shkruar në dy mënyra të ndryshme ajo që lexoni ju, por është pjesë e ISKSH-së. Pra, objektivi është furnizimi më i mirë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Dhëmbi!

Fjalën e ka zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Zonja Dhëmbi, faleminderit për paraqitjen e këtij projektbuxheti model tjetër, pra më transparent!

Kam një pyetje lidhur me aneksin 5 për qendrat e shërbimeve sociale, ku thoni se në transfertat e pakushtëzuara të disa bashkive përfshihet edhe fondi për disa qendra, a ka qendra të tjera sociale që nuk mbulohen në këtë buxhet të këto transfertat? Nëse ka, pse nuk janë përfshirë?

Pyetja e dytë ka të bëjë me taksimin e pasurisë. Në faqen 10 të raportit ju thoni se taksimi i pasurisë ka rënë me 5,8 për qind në krahasim me një vit më parë dhe se ka një nivel ende të lartë të informalitetit. A keni parashikuar në paketën fiskale keni një masë për parandalimin ose kufizimin e informalitetit, në vend të rritjes së taksave për shtëpitë e dyta ose qendrat turistike?

Pyetja e tretë lidhet me taksat vendore. Përsëri se taksat vendore ju thoni se janë nivele më të ulëta, megjithëse ka një rritje të mbledhjes së tyre, gjithsesi janë më të ulëta sesa parashikohen. Nga ana tjetër, keni thënë se nuk ka rritje të personelit në strukturën e organeve të qeverisjes vendore etj., si e keni parashikuar rritjen e performancës ose të mbledhjes më të mirë të taksave vendore, nëse nuk jepni këtë lloj mbështetje në financim?

Do ta rimarr pyetjen e zotit Vasili lidhur me furnizimin me medikamente. Në faqen 28 ju thoni: “Furnizim më i mirë me medikamente për shërbimin onkologjik dhe kardiologjik”. Presupozohet që të sëmuret që janë në trajtim për sëmundjet e kancerit etj. do të përfitojnë dhe nuk do të blejnë më barna para farmacive të spitaleve? Pra, a do të ketë një mbulim 100% të këtij furnizimi? Jo më larg se para 6 muajve e dimë që të gjithë i kanë blerë pranë farmacive.

Lidhur me të përndjekurit politikë, në faqen 29 të raportit që e shoqëron ju ngrini problemin se fondi i kompensimit do të vijë nga procesi i legalizimit të pronave, ALUIZNI-t, pjesa me e madhe, apo jo? A mendoni se do të mbulohen të gjitha këto shpenzime, kur dihet se një pjesë e mirë e pronave janë ende në proces dhe ka probleme dhe nuk mund të bëhen që në vitin e parë legalizimet?

Në faqen 30 flitet për shtresat në nevojë. Ju me të drejtë thoni këtu se ka një shtim të fondit prej 1,1 miliard si kompensim dhe për këtë jeni për t’u falënderuar. Pyetja ime është: a mendoni se ky fond është i mjaftueshëm për të mbuluar të gjitha nevojat që kanë shtresat në nevojë, apo do të ketë thjesht reduktim TVSH-je për energjinë dhe shportën? Shtresat në nevojë kanë edhe nevoja të tjera.

Oerd Bylykbashi – Po, zonja Dhëmbi.

Mimoza Dhëmbi – Lidhur me aneksin 5 të buxhetit vendor ne parashikojmë në këtë aneks të gjithë ato qendra që duhet të financohen nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar. Aneksin e bëjmë për të bërë të ditur se në ato bashki dhe komuna kemi vënë fond shtesë për ato qendra. Ka edhe qendra të tjera që janë akoma nën varësinë e Ministrisë së Punës, të cilat i kalojnë gradualisht pushtetit lokal. Kur t’i kalojnë pushtetit lokal, ne i shtojmë qendrën dhe fondin, pra për të qenë transparente.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kanë fond, por nëpërmjet ministrisë.

Tatimi i pasurisë, në fakt, është një nga taksat me mbledhshmërinë më të ulët, pasi ka probleme në regjistrimin e pasurisë. Është premtuar se do të ketë një proces të regjistrimit dhe të kthimit të pronës. Kjo gjë do kohë. Unë personalisht jam për atë: më mirë të luftojmë informalitetin sesa të rrisim taksat. Ideja është të fusim një taksë e cila të implementojë kulturën që edhe për shtëpinë e dytë të paguhet. Gradualisht do të përmirësojmë edhe informalitetin.

Procesi i regjistrimit dhe ai i kontrollit mbi territorin shpresojmë se do të jetë më i mirë. Të ardhurat që do të vijnë nga kjo taksë do të jenë të konsiderueshme.

Kemi thënë që taksat lokale do të rriten. Do të rritet edhe performanca e mbledhshmërisë së taksave vendore. Personelin nuk e kemi shtuar. Kjo gjë është e vërtetë. Shpenzimet e personelit, po t'i shikoni te neni përkatës, janë ulur me nga 5% për komunat dhe bashkitë, me idenë që taksa kryesore që ka të bëjë me biznesin e vogël është hequr, ndërsa pjesa tjetër e tatimit të thjeshtëzuar mbi tatimin e vogël, do të administrohet nga administrata qendrore. Duhet t'ia kishim hequr, por nuk ia kemi hequr një fond të caktuar pushtetit vendor, për këtë arsye, sepse administrata qendrore tani do të ketë një strukturë suplementare për të ndjekur këtë taksë që do ta mbledhë për hir të pushtetit vendor. Ne do të konsumojmë më tepër energji dhe para për t'i mbledhur të ardhurat e pushtetit lokal.

Për furnizimin me ilaçe, ju e thatë dhe unë nuk kam se çfarë të shtoj. Ne do të përmirësojmë furnizimin me medikamente të shtrenjta për Onkologjinë dhe Kardio-kirurgjinë me rreth një miliardë lekë. Ky objektiv është plotësuar me këtë buxhet dhe ne shpresojmë që furnizimi me ilaçe do të jetë njëqind për qind për këto dy sëmundje që janë të konsiderueshme në Shqipëri.

Te Fondi i Kompensimit të Pronarëve, po ta vini re, të ardhurat nga legalizimet janë parashikuar pak më të ulëta se viti i kaluar, sepse edhe procesi i një pjese është me bono privatizimi. Pjesa që do të mblidhet do të shkojë për pjesën që do të formalizohet, ndërsa vetëm një diferencë prej 300 milionë lekësh shkon për pronarët e vjetër. Me këtë gjë, jo se kemi gjetur ndonjë zgjidhje, por është një buxhet si të gjithë vitet e tjera dhe nuk kemi ndonjë ndryshim thelbësor në këtë pikë. Buxheti nuk mund t'i zgjidhë të gjitha prioritetet në një vit. Ky është buxheti i stabilitetit, duke mbajtur shpenzimet dhe politikat paksa të qëndrueshme pa shumë ekzagjerime, sepse ka shumë halle të tjera për të zgjidhur përpara, siç janë borxhet e vjetra.

Për shtresat në nevoja, ka qenë një diskutim se do të ulet TVSH-ja për mallrat e shportës dhe për energjinë elektrike. Në përgjithësi të gjithë ekspertët ndërkombëtarë, por edhe ne që kemi vite që punojmë, kemi parimin që TVSH-ja të çahet sa më pak me përjashtime, sepse çdo shkallëzim i TVSH-së krijon çarje edhe për gjëra të tjera, për një informalitet më të madh. Prandaj, sa më mirë të administrohet TVSH-ja dhe sa më

kompatke të jetë, aq më mirë është. Për këtë u propozua skema e kompensimeve. Meqenëse është premtuar se mallrat e shportës do të jenë me 10% dhe jo 20%, është llogaritur 10%-shi i shportës. Kjo masë është llogaritur me numrin e familjeve që do të jenë në nevojë. Pra, kështu është llogaritur ky fond. Po kështu edhe për energjinë. Është marrë 300 kilovatëshi, është llogaritur TVSH-ja për këtë sasi konsumi dhe është marrë numri i familjeve në nevojë. Skemat do të bëhen me vendime të qeverisë. Nëse e keni parë në nenet e ligjit, do të ketë vendime të qeverisë për kriteret, për mënyrën, sesi dhe sa do të kompensohet.

Oerd Bylykbashi - Po, zoti Halimi.

Eduard Halimi – Zonja Dhëmbi, ne do të kursejmë pyetjet politike, por në fakt ky është buxheti i parë i qeverisë së dalë nga zgjedhjet. Sigurisht që ka pjesën e programit politik. Unë nuk do të bëj pyetje për programin politik, sepse është pjesë e analizës sonë, por dua të jem i qartë në këtë analizë. Dua një përgjigje të thjeshtë dhe teknike nga ana juaj, a ka më shumë para për ish-pronarët në vitin 2014 sesa buxheti që diskutuam për vitin 2013? Nëse janë më shumë, sa janë? Pjesa e faturës së ALUIZNI-t vjet ka qenë 16 miliardë dhe jo 12. Ajo varet se sa do të mbledhim nga ALUIZNI.

Ka më shumë lekë për ish-pronarët apo janë më pak?

E dyta, për ish-të përndjekurit, që do të bënin çudira, do t'i shpërblenin me një këst, me dy këste, a kanë më shumë lekë sesa ishin parashikuar vjet apo ka më pak?

E treta, për sistemin gjyqësor dhe prokurorinë që është një nga komponentët në rrugën e integritetit, ka më shumë para apo më pak? Rritjen e pagave e bëmë ne me ligj. Juve tani po i vini 20% më shumë, se ata e kanë rrogën mbi një milion e 200 mijë lekë. Pra, 23% po ia merrni. Bashkimi Europian ishte skeptik edhe pse thoshte se duhet të luftoni korrupsionin në drejtësi, pastaj thoshte të rrisni pagat. Kjo rritje page ndaj prokurorëve ka rënë. Këta do marrin më shumë lekë nga ky buxhet apo më pak? Do të ketë më shumë investime në sistemin e drejtësisë, ashtu siç kishte vjet apo jo?

Këto janë pyetje teknike, brenda fushës së komisionit dhe janë çështje që i kemi diskutuar në komision.

Oerd Bylykbashi – Po, zonja Dhëmbi.

Mimoza Dhëmbi - Për ish-pronarët, siç e shpjegova edhe më parë, përveç ALUIZNI-t, pjesa tjetër është 300 milionë lekë, aq sa ka qenë në buxhetet tona të katër-

pesë vjetëve të fundit. Nuk ka shtesë, por është i barabartë. Për ish-të përndjekurit ka 1,8 miliardë. Në vitin 2013 ishin 3 miliardë, por ishte një vit pak i veçantë. Në vitet e tjera ka qenë rreth 1,8-2. Pra, është sa vitet e tjera, përjashtuar vitin 2013, që ishte vit elektorale.

Për sistemin gjyqësor, ju e thatë edhe vetë, se këtë vit ka më shumë para për rritjen e rrogave, që ju e bëtë, por e financon ky buxhet, sepse është vendosur fondi. Ka më shumë para për gjykatat administrative, sepse janë parashikuar shtesa të numrit të punonjësve dhe një shtesë për fondin e pagave. Shpenzimet e tjera janë aty-aty. Ne do t'i diskutojmë kur të vijë ata vetë dhe do t'i dëgjojmë nga goja e tyre.

Fatmir Xhafaj - Po, zoti Bylykbashi.

Oerd Bylykbashi – Zonja Dhëmbi, e kuptuam që për ish-të përndjekurit dhe ish-pronarët ka më pak para, gati gjyca më pak se viti që shkoj. Zoti ministër, tha se kemi paguar borxhet e komunizmit në të shkuarën. Në fakt ish-të përndjekurit dhe ish-pronarët janë borxh i komunizmit, jo vetëm nga ana morale, por edhe në para. Ju po thoni se nuk do të ketë para për ta. Ka diçka në lidhje me rehabilitimin e kësaj shtrese. Kjo nuk është pjesë që duhet t'i përgjigjeni, sepse nuk është për ju, por më gjerë. Kur tentohet të rehabilitohet figura e diktatorit, për të cilat ne paguajmë kusuret e komunizmit për këto shtresa, sigurisht bie figura e ish-të përndjekurve dhe ish-pronarëve. Kjo është normale, por dua të kuptoj: cila është arsyeja që është hequr programi i rehabilitimit të të përndjekurve politikë, që është për Institutin e të Përndjekurve Politikë? Ka ndonjë arsye përse është hequr fare, apo është ndonjë gabim në tabelat tuaja? Ju ka dalë tepër si zë?

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Bylykbashi!

Zonja Dhëmbi?

Mimoza Dhëmbi – Nuk e di ku e shikoni ju që nuk është, apo lexoni të gjithë programin dhe nuk ekziston? Më duhet ta verifikoj, sepse Instituti vazhdon të ekzistojë si program, varet në varësi të kujt ka shkuar tani dhe ndoshta nuk e shohim në programe. Më duhet ta verifikoj dhe t'ju kthej përgjigje një ditë tjetër. Por që duhet të jetë, duhet të jetë.

Oerd Bylykbashi – Na rezulton se është në Ministrinë e Drejtësisë.

Mimoza Dhëmbi – Më duhet ta verifikoj, sepse nuk ka pasur ndonjë politikë për ta hequr si institut ose si politikë të qeverisë; në mënyrë absolute.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Dhëmbi!

Fjalën e ka zoti Bylykbashi.

Oerd Bylykbashi – Sigurisht, pres një përgjigje përpara se të përmbyllet debati i përgjithshëm për këtë, por fakti që në buxhet nuk është, është tregues. Nuk besoj që qeveria harron kollaj gjëra të tilla, për sa kohë nuk është harruar kurrë në gjithë këto vite.

Një pyetje tjetër. Zoti ministër, edhe herë të tjera ka qenë evaziv në këtë komision, kur flet për çështje të caktuara. Tha që të gjitha njësitë vendore do të marrin më shumë para këtë vit, ndërsa disa të tjera do të marrin më shumë, dhe kjo mbi bazën e një formule të caktuar. Tani si ta kuptoj këtë formulën e caktuar për të kuptuar nëse ka, nëse mund të ketë diskriminim politik karshi disa njësive, në favor të disa njësive dhe kundër disa njësive të tjera? Na e shpjegoni dot me fjalë të thjeshta se cila është formula?

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Fjalën e ka zonja Dhëmbi.

Mimoza Dhëmbi – Atëherë, transferta e pakushtëzuar e pushtetit vendor ndahet sipas një formule. Ministri tha: sipas një formule të caktuar. Në fakt, është një formulë ligjore dhe është pjesë e këtij ligji. Tek aneksi nr.1 është formula se si është ndarë dhe aty janë të detajuara se sa për qind është popullsia, se sa për qind është sipërfaqja. Ajo është formula që zbërthehet pastaj në tabelën nr.3, e cila është tabela që thotë sesa i bie secilit. Nga viti i kaluar ka ndryshuar një element. Nga numri i popullsisë sipas censusit, është marrë numri i popullsisë sipas gjendjes civile, siç ka qenë historikisht. Vitin e kaluar bëmë një eksperimentim, meqenëse kishim të dhënat e freskëta të censusit, ndërsa këtë vit jemi kthyer te gjendja civile. Nga kjo mund të ketë ndonjë diferencë me vitin e kaluar, por formula është e njëjtë për të gjithë, sepse kur merret gjendja civile, merret për të gjithë njësoj. Tani të gjithë fitojnë, sepse ne kemi vënë një dysHEME dhe tavan. Kemi thënë që asnjë nuk do të marrë më pak se vitin e kaluar. Madje është thënë: “101%”, ku çdo komunë dhe bashki duhet të ketë 101% deri në 108%. Kaq është hapur gërshëra. Pra, pavarësisht nga numri i popullsisë, nga censusi në gjendjen civile, diferencat, që mund të jenë nga viti i kaluar, janë nga 1% deri në 8%. Kjo është hapësira dhe nuk është shumë e madhe. Pra, nuk ka përfitues shumë të mëdhenj dhe humbës të mëdhenj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Dhëmbi!

Keni pyetje të tjera, zoti Bylykbashi?

Fjalën e ka zoti Bylykbashi.

(Deputeti Bylykbashi flet pa mikrofon.)

Po, zonja Dhëmbi.

Mimoza Dhëmbi – Atëherë, unë përmenda që shpenzimet e personelit në pushtetin vendor nuk janë rritur, për arsye se ata do të kenë edhe një lehtësim nga administrimi i taksave.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në fakt, ajo që do të administrohet në mënyrë qendrore është vetëm taksa e thjeshtëzuar e biznesit të vogël dhe taksat e tjera, si të ndërtesës, taksat lokale, të reklamës etj., do të vazhdojnë t'i ngelen pushtetit vendor. Ndërsa vetëm taksa që lidhet me biznesin, pra taksa e thjeshtëzuar e biznesit të vogël, do të mbledhet në mënyrë qendrore. Jo të gjitha taksat.

Kjo i kushton administratës qendrore, sepse kërkon më shumë burime njerëzore, por ne nuk kemi parashikuar rritje të numrit të punonjësve. Këto do të përballohen nga shkurtimet e brendshme në sektorë të tjerë, sidomos në Tiranë, për shembull, po të merresh me biznesin e vogël, do një administratë të përcaktuar.

Efekti në centralizim, në fakt, nuk është se ka ndonjë risk të madh. Madje, ne kemi gjetur edhe anë pozitive në këtë anë, për faktin që duke administruar biznesin e vogël, administrata qendrore mund ta konstatojë kur ky biznes bëhet i madh. Pushteti lokal nuk kishte asnjë interes që biznesin e vogël ta quante biznes të madh dhe të futej në skemën e TVSH-së, sepse ishin të ndarë, por duke qenë në një administratë, ata mund ta vlerësojnë më drejt dhe biznesi shkon atje. Me këtë mendohet se reduktohet një pjesë e informalitetit. Pra, ka eficiencë në administrimin e taksave.

Nga pikëpamja e transferimit, unë nuk besoj të ketë një urdhër politik që të mos transferohet, sepse edhe sot...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në mënyrë absolute, sepse ka sistem. Gjërat janë të kompjuterizuara, do të ketë një sistem rakordimesh të njësisë vendore çdo 3 muaj me administratën tatimore dhe automatikisht do t'i kalojë sistemit thesar. Madje, edhe sot, ata janë nëpërmjet sistemit të thesarit. Po të donte t'i bllokonte pushteti qendror, i bllokonte. Pushteti vendor nuk ka llogari. Llogarinë tonë të thesarit kanë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po nuk mund të bëjë jashtë ligjit, sepse pushteti qendror mund të urdhërojë, por nëse urdhri është i paligjshëm, jemi ne që nuk e zbatojmë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Dhëmbi!

Koha e gjatë ju ka bërë që t'i zgjasni edhe përgjigjet.

Ka pyetje të tjera nga kolegët?

Po, zoti Duzha.

Luan Duzha – Kisha një pyetje për transfertën e pakushtëzuar për komunat dhe bashkitë, se mbi çfarë kriteresh është bërë kjo ndarje.

Fatmir Xhafaj – Kjo pyetje është konsumuar, sepse e bëri edhe zoti Bylykbashi dhe u dha përgjigjja.

Faleminderit, zoti Duzha!

Fjalën e ka zoti Ndoka.

Nard Ndoka – Faleminderit, zoti kryetar!

Zonja Dhëmbi, besoj e keni dëgjuar sapo nisi fushata e qeverisë për lënien e mandateve, se do të ketë një kosto financiare për faktin që është goxha e rëndësishme për buxhetin, se është një shtesë page për 20 ministra. Më duket se Kryeministri nuk e dorëzon mandatin për 20 ministra. Është një kosto shumë e madhe për parlamentin, se këto normalisht janë buxhetuar si pjesë e qeverisë, pra i shtohen buxhetit të shtetit edhe 20 persona të tjerë parazitë me këtë lëvizje demografike politike të kësaj maxhorance.

A është parashikuar në buxhet një rritje e tillë?

Mimoza Dhëmbi – Tamam nuk mund ta them se sa është shuma, por është parashikuar dhe shtesë numri punonjësish për Kuvendin. Megjithatë më duhet ta saktësoj edhe fondin edhe numrin. S'mund ta them ekzaktësisht, sepse është pjesë e buxhetit të Kuvendit. Do t'jua them, herën tjetër kur të vij prapë. Sa është fondi dhe numri nuk e them dot për momentin.

Fatmir Xhafaj – Zoti Halimi, urdhëroni!

Eduard Halimi – Në vijim të pyetjes së zotit Ndoka, për të qenë të qartë edhe ne, buxheti i parashikuar për administratën e këtij vendi, barra që do të përballojnë qytetarët shqiptarë për administratën e 2013-s është më i vogël apo më i madh për 2014-n? Pra, shtimi i gjashtë ministrive bashkë me shkurtimet e administratës, bashkë me ndryshimin e

mandateve, ky zë në buxhet, kjo barrë është më e lehtë apo më e rëndë? Nëse është më e lehtë, sa më e lehtë është? Nëse është më e rëndë, sa më e rëndë është?

Mimoza Dhëmbi – Shtesa e ministrive të reja është përballuar nga shkurtimet e aparateve të ministrive. Efekti është diçka minus, por shumë i vogël. Meqenëse reforma për shkurtimin me 30% të administratës po vazhdon edhe në institucionet e varësisë, në fondin e pagave nuk kemi parashikuar asnjë ulje. Po ta shihni, fondi i personelit është pa ulje, sepse ne parashikojmë që me gjithë shkurtimet ka një kosto të të larguarve, që është relativisht një vit. Efektet e shkurtimeve të këtij viti nuk janë marrë parasysh si kursime, por janë lënë në fondin e pagave për të përballuar edhe kostot e largimeve. Në vitin 2015 shpresoj se do të kemi kursime nga kjo reformë, e cila nuk ka përfunduar. Ne nuk i kemi shifrat më të fundit, pasi ato janë të gjitha në proces dhe aty ku nuk e kemi strukturën më të fundit kemi lënë numrin e vjetër të punonjësve, pra, kemi marrë maksimumin. Për ministritë e reja numri dhe kostoja është përballuar me shkurtimet e aparateve dhe ka një reduktim fare të vogël. Për të gjitha reduktimet nuk është marrë parasysh asnjë kursim.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Subashi!

Armando Subashi – Kam dy pyetje, zonja Dhëmbi. Kam këtu tabelën nr. 3, ku është dhënë transferta e pakushtëzuar për qarqet. Më bën përshtypje si qarqe shumë të vegjël kanë një fond shumë më të madh nga transferta e pakushtëzuar, në raport me qarqet e mëdha, siç mund të jenë Tirana, Fieri, Elbasani, Durrësi etj. Do të doja një informacion se cila është formula e ndarjes së fondeve në raport me qarqet? Pyetja e dytë: Në bazë të ligjit “Për rentën minerare” ka disa njësi vendore në Shqipëri që duhet të përfitojnë një pjesë të rentës minerare që paguhet dhe t’u kthehet mbrapsht që ato të kenë më shumë mundësi për investime etj. Është një normë e njohur ndërkombëtare që vepron në të gjitha këto raste. Për fat të keq, në qeverisjen e mëparshme nuk u zbatua asnjëherë, megjithëse ligjin e miratuan vetë. Nuk e shoh të pasqyruar këtë gjë në ligjin për buxhetin e këtij viti dhe përderisa nuk e shoh të pasqyruar, kam frikë se nuk do të zbatohet edhe këtë vit. Nëse është kështu, a ekziston mundësia që, për këto njësi vendore, të cilat në bazë të ligjit duhet të përfitonin një pjesë të rentës minerare të shtohet diçka te granti i pakushtëzuar që qeveria u jep?

Shoh një pjesë të bashkive dhe komunave në Fier, që normalisht duhet të përfitonin nga renta minerare, dhe që kanë pothuajse të njëjtën shumë që kanë pasur edhe parvjet. Nuk po them vjet, sepse vjet e dimë shumë mirë që ishte formula mbi bazën e censusit dhe e ul goxha granti, por janë në nivelin e dy vjetëve më parë. A ka mundësi të rishikohet kjo dhe të kenë një shtesë që ta marrin të paktën në 20% rentën?

Mimoza Dhëmbi – Në lidhje me qarqet, formula është në aneksin nr.1. Atje ku keni ndarjen e fondeve për bashkitë dhe komunat është edhe aneksi për qarqet. Përveç popullsisë, kam idenë se koeficienti që ndikon më shumë është ai i rrugëve rurale, sepse mirëmbajtja e rrugëve ka qenë funksioni i qarqeve. Ajo ka ndikuar. Pastaj, pse është kaq apo aq, mund të shohim se si janë ndërtuar shifrat. Në lidhje me rentën mund t’ju sqaroj se është zbatuar, por është zbatuar me një tavan. Para dy vjetësh kishim një tavan 30% mbi grantin. Këto para vijnë në buxhet dhe autorizohen 20% për pushtetin vendor. Këtë vit është parashikuar një shumë prej 800 milionësh. Cili është ndryshimi këtë vit? Vjet ishte 50% tavani sivjet e kemi ndarë 50% për nxjerrje nafte dhe 80% për ata që e kanë minerare, sepse aty renta minerare është shumë e ulët. Kemi bërë një përpjekje të re për ta rritur pak tavanin. Kjo është ideja për të përmirësuar pjesën e rentës që shkon direkt për njësitë vendore. Deri në 800 milion ua kemi lejuar. Ky është grant më vete dhe do të jepet në momentin që na vijnë dokumentet nga administrata tatimore-doganore. Ne i rakordojmë pastaj direkt.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti Fino, urdhëroni!

Bashkim Fino – Faleminderit, zoti Kryetar!

E kam lexuar projektbuxhetin me shumë kujdes. Jam shumë i kënaqur që kolegët e opozitës nuk kanë vërejtje për projektin e buxhetit lokal, sepse është pothuajse në të njëjtët parametra politikë siç ka qenë edhe i vjetshmi. Më duhet të bëj atë diskutim që kam bërë edhe vjet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më lër ta mbaroj!

Unë, si deputet që kam nënshkruar kartën e autonomisë lokale, ku kemi kërkuar me forcë decentralizimin e pushtetit vendor, për të cilin nuk është bërë asgjë nga qeveria e kaluar, vazhdoj të këmbëngul me forcë në pyetjet që kam bërë edhe vitin e kaluar, por i

vazhdoj edhe këtë vit. Më lejoni të hyj në anët më teknike, meqë specialistja ka një përvojë të gjatë, me ne dhe me ata. Nuk po lexoj më rentën minerare. Nuk po lexoj nenin 15 të ligjit, por diçka tjetër më profesionale. Po lexoj te renta minerare, ku thuhet se 50% e transfertës së pakushtëzuar për naftën dhe gazin dhe 80% për minierat. Kush jeni ju që vendosni në një ligj të buxhetit të shtetit për t'u dhënë lëmoshë organeve të pushtetit vendor, kur parlamenti me shumicë votash ka miratuar një ligj ku thotë që 25% të rentës minerare u kalojnë automatikisht organeve të pushtetit vendor? Ti si ministri je e detyruar ta respektosh këtë ligj. Nëse Bulqiza merr 25% të rentës minerare, s'ka nevojë të marrë fare grante të pakushtëzuara. Nëse e kemi bërë gabim këtë ligj, na sillni projektin ta abrogojmë, të themi të marrë 5%, 10% apo 15%. Me këtë pasqyrë në fund ju u thoni deputetëve se “unë, Ministria e Financave, kam të drejtë të jap deri në 80% të rentës minerare (përtej asaj të 25%).

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, të grantit. Ju thoni se “renta minerare u alokohet qeverisjeve vendore sipas kërkesës së tyre”. Ata e kanë të shkruar në ligj se sa do ta marrin. Pse duhet kërkesa? Vazhdojmë më poshtë: “Njësia e qeverisjes vendore përfiton 50% për naftën dhe gazin dhe 80% për minierat e rentës minerare mbi transfertën e pakushtëzuar, pasi transferta dhe renta të jenë barazuar.” Me këtë aneks me germa të vogla ju u thoni organeve të pushtetit vendor se e kemi kaluar kot atë ligj. Kjo është pyetja e parë.

Pyetja e dytë. Kam qenë kundërshtari numër një i qeverisë së shkuar kur ka ardhur këtu Ridvan Bode dhe ka kërkuar me forcë nga organet e pushtetit vendor që, nëse nuk kishin shlyer detyrimet e CEZ-it, automatikisht do të ndërhynte Ministria e Financave dhe do t'u rrëmbente grantin e pakushtëzuar të 3-mujorit të fundit, ndërsa granti i 3-mujorit të katërt do të shkonte për këto shlyerje. Ky qe një arbitraritet. Këtë arbitraritet e keni te neni 15 në paragrafin ku thuhet: “Kur shoqëritë aksionere të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe njësive të qeverisjes vendore për sistemimin e pompimit, rezultojnë debitorë për kursimin e energjisë elektrike ndaj kompanisë së shpërndarjes deri në fund të 3-mujorit të tretë, transferta e pakushtëzuar e njësive të qeverisjes vendore për 3-mujorin e katërt bllokohet dhe përdoret për shlyerjen e detyrimeve.” Çfarë dua të them me këtë, zoti kryetar? Jam shumë i bindur se Partia Demokratike do ta votojë nenin 15 me të dyja duart. Unë vetë do të votoj kundër. Do të votoj pro për buxhetin, por kundër

për këtë nen. Pra, janë dy momente që më krijojnë pakënaqësi të jashtëzakonshme. Pa llogaritur nenin 15.

Pyetja e fundit. Meqenëse mbuloj Nënkomisionin e Pushtetit Vendor, kërkoj që drejtuesit më të specializuar të vijnë dhe të na argumentojnë, sepse kanë shifra diametralisht të kundërta, edhe për shkak se tani ka vepruar gjendja civile e jo censusi. Kanë një shifër shumë të kundërt për transfertën e pakushtëzuar. Është e vërtetë ajo që tha Moza që në përgjithësi është rritur marzhi në 8% i grantit të pakushtëzuar nga viti i kaluar. Pra, dikush ka marrë 101, dikush 104%, dikush 108%, por dikush edhe 120%. Po në përgjithësi është te 8%. Por ne nuk mund të luajmë me organet e pushtetit lokal, duke u thënë që po jua rritim deri në 10% e mos bëni zë. Unë këtu kam një pasqyrë dhe përqindjet, që i kam nxjerrë vetë, të vitit 2013 dhe të vitit 2014, dhe më rezulton që shumë komuna e bashki kanë një disnivel të madh për nga numri i popullsisë. Ka komuna me 4000 mijë banorë që marrin 22 milionë lekë grant. Ka bashki me 8 mijë banorë që marrin 20 milionë grant. Po ju jap dy shembuj dhe të dy janë politike dhe këtë e kam pyetje politike për ministrin, për atë që e ka bërë.

Ne këtu në komision arritëm me ndihmën e nënkryetarit të Kuvendit aktual, t'i ndërronim emrin Komunës së Liqenasit, që është një komunë maqedonase me 4 mijë banorë, komunë e bukur, shumë e mirë, që është drejtuar politikisht nga nënkryetari i këtij parlamenti që është sot, që ka qenë edhe kryetar i komisionit të Ekonomisë për tetë vjet. E dini sa e ka transfertën e pakushtëzuar kjo komunë? 22 milionë. A e dini sa e ka Bashkia e Maliqit që ka dyfishin e banorëve të kësaj komune? 22 milionë. Si ka mundësi që një komunë e vogël me 4 mijë banorë dhe një bashki me 8 mijë banorë të kenë të njëjtën shifër të transfertës së pakushtëzuar?

Përgjigjen e kam vetë: ka mundësi, sepse drejtuesi i komisionit për tetë vjet ka bërë të mundur që transferta të jetë shumë e madhe. Ia ka hedhur edhe Edi Palokës. Nuk e di nëse ky kryetar i tanishëm i komisionit do të japë gjë për Divjakën?

Pra, ai ka dhënë para për tetë vjet në vazhdimësi njësoj sa Bashkia e Maliqit. E kuptoni çfarë ndryshimi i madh është? Prandaj, unë propozoj që nënkomisioni ynë të ketë një seancë, ku është i ftuar kushdo, edhe nga Komisioni i Ligjeve, për të na dhënë detajime profesionale Ministria e Financave për ndarjen e transfertës së pakushtëzuar. Transferta e pakushtëzuar është e të gjithëve dhe duhet ta marr kushdo njëloj pa dallime

politike. I takon, ta marrë, por nuk mund të bëjmë qoka me këtë tranfertë siç është bërë deri tani.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Fino edhe për komentet që bëtë, edhe për propozimin!

Këshilltarët e komisionit të marrin masa që të organizojnë seancën e posaçme me nënkomisionin e këtij komisioni, i cili ka të bëjë me qeverisjen vendore, të thërrasin ekspertët e Ministrisë së Financave për të dhënë shpjegimet përkatëse dhe, nëse e shohin të arsyeshme, edhe shoqata të tjera që kanë interes për këtë çështje, duke bërë të njohur edhe ditën, edhe orën, por, natyrisht, kjo seancë dëgjimore do të jetë pa dëmtuar oraret e seancave dëgjimore që ka komisioni.

Kush e do fjalën për diskutim?

Zoti Paloka.

Edi Paloka – Fillimisht, zoti kryetar, meqë Bashkimi kishte hallin tim, unë uroj që zoti Fino këtë herë ta mbajë fjalën dhe të votojë kundër.

(Diskutime pa mikrofon.)

Thjesht uroj që ta mbash fjalën edhe këtë herë. Unë nuk kam dhënë ndonjë fjalë që do të votoj. Kur u votua për kryetarin e Gjykatës Kushtetuese ju thatë: “Do të votoj kundër” dhe nuk e bëtë.

Lidhur me projektbuxhetin nuk do të zgjatem, sepse besoj se është e qartë edhe për të gjithë shqiptarët, por dhe për ata që nuk është e qartë, do të bëhet e qartë në shkurt dhe në mars se çfarë do të ndodhë me këtë paketë fiskale që i ka ardhur Kuvendit dhe me këtë projektbuxhet. Me pak fjalë do të them vetëm kaq: me këto dy paketa, po e quaj dhe projektbuxhetin paketë, shqiptarëve u rriten pagesat që do të bëjnë për këtë qeveri, u ikin para nga xhepi i tyre dhe çka është më e keqja, me këtë projektbuxhet, këto para, që u merren shqiptarëve, nuk u kthehen atyre më në forma të tjera investimesh, sigurimesh, të cilat buxheti ka për detyrë t'ua kthejë, por kalojnë kryesisht për shpenzime të qeverisë, shpenzime që janë rritur në krahasim me vitin e kaluar. Megjithëse qeveria thotë se jemi në gropë, jemi në krizë financiare, kjo nuk e pengon aspak që ta rrisë me gati 60 milionë dollarë thesin e parave që ka llogaritur për shpenzimet e saj.

Ndërkohë, me gjithë premtimet që kjo qeveri ka bërë, për fat të mirë nuk ka kaluar shumë kohë dhe janë të freskëta premtimet që u bëri ish-pronarëve, ish-të

përndjekurve politike dhe shumë shtresave të tjera se do t'i shpëtonte nga diskriminimi që u kishte bërë Berisha për vite të tëra, do t'i lante detyrimet ndaj tyre brenda pak kohësh, rezulton se me këtë buxhet për ish-pronarët dhe për ish të përndjekurit jo vetëm që nuk jepen ato shuma që ka dhënë qeveria Berisha, por gati janë përgjysmuar paratë që shkojnë për këto shtresa. E njëjta gjë ndodh dhe për shtresa të tjera, por thashë që nuk do të zgjatem, sepse efektet e këtyre dhuratave që Rama po u bën shqiptarëve për Vitin e Ri do t'i ndiejnë më mirë se kushdo ata vetë, duke filluar që nga shkurti i vitit tjetër.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit, zoti Paloka!

Ka ndonjë deputet tjetër që do të diskutojë? Nuk ka.

I mbylлим diskutimet.

Kush është dakord? Kundër?

Faleminderit!

Miratohet në parim projektbuxheti.

Diskutimet nen për nen do të bëhen pasi të dëgjohen seancat dëgjimore. Dëshiroj t'ju bëj me dije se nesër kemi seancë dëgjimore paradite dhe pasdite. Paradite në çdo 30 minuta, lidhur me projektbuxhetin, do të dëgjojmë institucionet e Ministrisë së Drejtësisë, të Prokurorisë së Përgjithshme, të Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të Gjykatës Kushtetuese. Ndërsa në orën 16.00 ministrin për Pushtetin Vendor, ministrin për Inovacionin dhe Administratën Publike, Ministrinë e Brendshme, Avokatin e Popullit dhe Inspektoratin e Lartë të Deklarimit të Pasurive. Ministria e Brendshme do të kalojë ditën e premte për shkak se ministri është i zënë. Ndërsa ditën e premte, në orën 10.00 do të jenë KQZ-ja, Shkolla e Magjistraturës, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Kemi shtuar Institutin e ish-të Përndjekurve me propozim të zonjës Hysi, ndërkohë do të bëhet një seancë dëgjimore, siç vendosëm këtu, me Nënkomisionin për Qeverisjen Vendore. Nëse ka diçka tjetër, duhet të më thoni sot, sepse koha për t'i njoftuar është tepër e limituar. Gjithashtu, ju bëj me dije se në kutitë postare të secilit deputet janë dekretet e Presidentit për kandidatët për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, pasi, sipas një praktike të shëndetshme të këtij komisioni, kemi nisur punën. Për të marrë të dhënat e nevojshme, nëse ka diçka dhe për këto praktika, për të shtuar apo për të bërë kërkesa, jeni

gjithashtu të mirëpritur. Në adresë të komisionit kanë ardhur edhe kandidaturat për përzgjedhjen e tri komisionarëve të Institucionit të Avokatit të Popullit.

MBLEDHJA MBYLLET

Sekretar
Armando Subashi

Përgjegjëse e sektorit të
komisioneve parlamentare
Euzheni Pengili